



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1183 Prot.

Durrës, më 25.04.2025

VENDIM

Nr. 44, datë 25.04 2025

"PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER I SHKENCAVE NË "ENVIRONMENTAL, CULTURAL AND TOURISM ECONOMICS" NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN ITALIANE "ECONOMIA DELL'AMBIENTE, DELLA CULTURA E DEL TURISMO", PRANË DEPARTAMENTIT TË TURIZMIT, FAKULTETI I BIZNESIT, UAMD ME FAKULTETIN E EKONOMISË, UNIVERSITETI LA SAPIENZA, ROMË"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Statutin e UAMD-së; Rregulloren e UAMD-së, si edhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 715/2 prot., datë 04.03.2025, vendimit të Senatit Akademik nr. 20, datë 05.03.2025, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Environmental, Cultural and Tourism Economics" në gjuhën angleze dhe në gjuhën italiane "Economia dell'Ambiente, della Cultura e del Turismo", pranë Departamentit të Turizmit, Fakulteti i Biznesit, UAMD me Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti La Sapienza, Romë.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 1200 lekë/kredit.
3. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhët shqip, anglisht, italisht.
4. Kodi i Programi : **LM-76**
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
6. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

